



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **26.10.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. **Kryesuesi** – Përshëndetje për nënkryetarin e komunës z. Fatmir Iska, për monitoruesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, SHL-Kosova, profesororeshën së bashku me nxënësit e shkollë së mesme “Selajdin Mullabazi – Mici”, që sot i kemi prezent, përfaqësuesit e mediave, drejtorët e drejtorive komunale, delegatët e kuvendit komunal dhe gjithë të pranishmit.. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal për periudhën janar – shtator 2018,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft - rregullores për Shërbime Publike,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi propozimit të Kryetarit që të i jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi propozimit të Kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës P- 71510031-00290-0, në fshatin Zatriq,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit për Ridestnim të mjeteve në buxhetin e vitit 2018,
8. Informatë e tretë mbi ecurinë e hartimit të PZHK-së.

Nr. i prot. 3156 Më 27.11.2018
Br. prot. Dt. 2018
RAHOVEC - ORAHOVAC

Kryesuesi – Të nderuar para se të ja fillojmë me mbledhje, desha që të ju njoftoj se komisioni për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane është formuar, anëtar të këtij komisioni nga radhët e kuvendit janë: z. Rexhep Oruçi, z. Afrim Berisha, z. Faton Ramadani, kurse nga ekzekutivi janë: znj. Saranda Sallteku, z. Përparim Krasniqi, përfaqësuesi i SHHL-Kosova z. Adnan Rexha dhe një përfaqësues nga çdo fshat ku shkojmë. Kishte me qenë mirë që ju si anëtar të komisionit të takoheni dhe ta zgjidhni kryesuesin e komisionit në mënyrë që të fillojmë me procedurat për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane. Ne ju kemi kopjuar secilit anëtar të komisionit rregulloren për zgjedhjen e këshillave, në mënyrë që të keni më lehtë punën tuaj. Kalojmë tani në punën tonë të rregullt sa i takon mbledhjes së sodit, a ka të shtoj dikush diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, I nderuari kryesues desha të ju njoftoj se emali rreth mbledhjes së sodit nuk më ka ardhur ndërsa kopja fizike po, meqenëse e kam marrë shumë vonë informatën

kurse unë po me këtë datë kamë planifikuar të shkojë në Tetovë për ta kryer një punë, pra kjo ka qenë arsyeja pse kam munguar në mbledhjen e kaluar.

Kryesuesi – Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

Vjosa Isma – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari kryesues në procesverbal sa kam vërejtur nuk është përfshirë diskutimi imë i cili ka qenë pas fjalimit të drejtorit të DKA-së, po ashtu edhe pjesa ku ka diskutuar z. Sali Sallteku nuk është përfshirë në procesverbal. Arsyen pse ka ndodhë kjo nuk e di por besoj kjo punë do rregullohet.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kamë një vërejtje të vogël sa i përket procesverbalit tek faqja nr.18, ku ceket se z. Fehmi Cena është zëvendës drejtor në QKMF, nuk ka pozitë të zëvendës drejtorit në statutin e QKMF-së, por kryeshef i departamentit të mjekësisë familjare, është mirë që ky ndryshim të bëhet.

Kryesuesi – A ka edhe dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në aprovim procesverbalit nga mbledhja e kaluar: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1), e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Kryesuesi – A ka ndonjëri nga drejtorët që nuk ju është përgjigjur pyetjeve nga mbledhja e kaluar, nëse ka atëherë mundeni të dilni që të ju përgjigjeni pyetjeve të parashtruara nga kuvendarët, nëse jo atëherë fjalën e keni ju kuvendarë që të parashtroni pyetje ekzekutivit.

Faton Ramadani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, i nderuar kryesia e këshillit të prindërve të shkollave kanë dalë në teren ku e kanë parë gjendjen e të gjitha shkollave të komunës sonë, konstatimi i tyre është se në shumicën e shkollave gjendja fizike është shumë e keqe sidomos tek tualetet në nyje sanitare. Në bazë të fotove që i kamë parë unë me të vërtet jam shumë i shqetësuar dhe çuditërisht pse është kështu kjo gjendje, pyetje ime për drejtorin e DKA-së është: A jeni në dijeni ju për këtë gjendje, a e keni pranuar raportin e këshillit të prindërve, nëse po a keni filluar të merrni ndonjë masë sa i përket kësaj gjendje.

Afërdita Thaqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, shqetësimi imë është rreth shkarkimit të drejtorit të DKRS-së, ku pastaj është zëvendësuar me një tjetër, por ne si kuvend nuk kemi asnjë informatë pse është bërë ky shkarkim, ne kemi informacione se ka dhënë dorëheqje, por kemi po ashtu informacione se ka shkuar në Stone Castle ku i ka kërkuar rreth 100,000.00 €, ku pastaj është njoftuar kryetari, ku pastaj e ka liruar nga çdo detyrë. Kurse rasti tjetër i zëvendësministrit z. Musa Cena dihet sepse është bërë e madhe edhe në medime, për vete këtë jam duke e marrë si shqetësim sepse ne si komunë jemi duke marrë një pasqyrë shumë të keqe. A pritët edhe dikush tjetër të dele në këtë gjendje nga drejtorët e juaj ose kuvendarët e juaj, sepse me të vërtet nuk është ka dihet se çka është duke u bërë me ju.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, çështja të cilën do e ngris unë është për drejtorin e shëndetësisë, është shqetësim për të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe gjithë Kosovën, fjalën e kamë për recetat të cilët i japin mjekët shkruhen ende me dorë, kur shkojmë në barnatore farmacistët nuk po munden ndonjëherë të i lexojnë për arsye të shkrimit, ka raste që jepen barnat ose medikamentet e gabuara. A ka mundësi që këto receta të shkruhen me kompjuter, nëse nuk kanë kompjuter ne duhet që të planifikojmë që në të ardhmen të blihen këta kompjuter. Pyetje tjetër shkon për drejtorin e DKA-së, çerdhja Tulipanët a është duke u ndërtuar me buxhet vetëm të ministrisë, apo është i paraparë edhe buxheti i komunës së Rahovecit, pastaj kjo çerdhe a do të përfundojë këtë vit apo vitin e ardhshëm, kërkesat e grave janë që mundësisht kjo çerdhe të ndërtohet sa ma shpejtë në mënyrë që fëmijët të barten në këtë çerdhe.

Rexhep Oruçi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do e ri aktualizoj një çështje të cilën ne si kuvend diku në muajin Mars ose Prill e kemi diskutuar çështjen e stacionit të autobusëve, vetë jam në atë komision por me të vërtet nuk e di se çka është bërë më tutje rreth këtij stacioni. Ne e dimë se në çfarë gjendje është stacioni i autobusëve, çdo ditë është duke krijuar humbje dhe duke na lënë borxhe, pa e ndërpre një agoni të

tillë ne stacionin e autobusëve nuk do e rikthejmë mbi vete. Ky është një aset komunal goxha i madh, transformimi duhet të bëhet sa më shpejtë sepse është një pronë me vlerë shumë të madhe, frikohem se nëse nuk ndërmarrim hapa të përshpejtuara mos dikur shkon edhe në likuidim vetëm që të mbulohen borxhet e personelit. Kishte me qenë mirë që drejtori të na përgatit një raport ose një informatë për seancën e radhës dhe të shikojmë se çka do të bëjmë më tutje, me të vërtetë më brengos fakti sepse të i lihet askujt një aset me një vlerë goxha të mirë është për tu habitur.

Afrim Berisha – Përshëndetje për ët gjithë të pranishmit, kam një kërkesë për drejtorin e bujqësisë nga banorët e fshatit Dejnë, ata kërkojnë që rruga që shpije tek tokat dhe livadhet e tyre është në një gjendje shumë të keqe dhe ata nuk po kanë mundësi që të shkojnë me mjetet e tyre, shpresoj që ju të reflektoni pozitivisht në mënyrë që të ju jepet mundësia banorëve të tyre që të shkojnë në pronat e tyre. Kjo rrugë nuk është shumë e gjatë përafërsisht diku rreth 170 m, mbesim me shpresë se kjo kërkesë e banorëve të fshatit Dejnë do të mirëet parasysht. Kërkesa tjetër është nga këshilli drejtues i shkollës fillore të fshatit Dejnë, kjo kërkesë shkon për drejtorinë e shërbimeve publike, ku kërkojnë nga kjo drejtori që të ja mundëson rregullimin e një parkingu për automjetet e personelit të shkollës, pasi që automjetet e personelit të shkollës nuk kanë mundësi që të parkohen diku tjetër, prandaj është shumë i nevojshëm një parking brenda oborrit të shkollës, shumë herë po kemi ankesa nga banorët e fshatit sepse makinat tona të parkuara janë duke penguar qarkullimin e lirë në rrugë. Shpresojmë se kjo kërkesë do të shqyrtohet dhe si e tillë edhe të miratohet.

Shqipe Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, arsyeja pse e mora fjalën është sepse e praqes si shqetësim sigurinë në komunën tonë, në kohën e fundit në komunën tonë janë duke ndodhur shumë vjedhje, si në fshatin Xërxë dhe fshatrat e tjerë. A është duke u marr ndonjë masë rreth kësaj, kishte me qenë mirë që të dalin më shpesh disa policë civilë. Kurse pyetje e dytë është e njëjta me znj. Afërdita Thaqi për ish drejtorin e kulturës.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë për një lagje në Fortesë, kjo kërkesë ka të bëjë për një kanal të hapur i cili gjendet në rrugën kryesore Sopniq – Fortes, kanali është me një gjatësi prej 33 m dhe 3 m gjerësi, ky kanal kundërmon një erë shumë të keqe gjatë sezonit të verës, kurse gjatë stinës së dimrit del nga shtrati. Për shkak të këtij kanali kjo pjesë nuk ka rrugë për këmbësor dhe në këtë mënyrë shkaktohen shumë aksidente, ky kanal ka nevojë që të mbyllet dhe në këtë mënyrë do të krijohen kushtet për këmbësor.

Fehmi Cena – Desha të i ngris dy çështje, njëra ka të bëjë me arsimin kurse tjetra me shërbime publike. Tek arsimi çështja është rreth ekskursionit të maturantëve që është një praktik e parvjetshme që shkojnë nxënësit dhe profesorët në shëtitje në Shqipëri, ka vërejtje rreth kësaj nga ana e prindërve dhe qytetarëve për disa arsye: Nxënësit nuk janë duke u mbajtur aq sa duhet nën kontroll nga profesorët, pastaj ka të dhëna se atyre ju është lejuar haptazi nga profesorët përdorimi i pijeve alkoolike dhe cigarja, kur e kemi këtë parasysht dhe gjendjen se si është në Shqipëri rreth përdorimit të substancave narkotike kjo paraqet një rrezikshmëri goxha të lartë, pastaj ndërprerja e mësimin, mbyllja e asaj shkolle që nxënësit i kanë shkuar në ekskursion. Ne këtu kemi vërejtje dhe nuk e di pse është mare ky vendim që të mbyllet shkolla, ne e dimë që në këto shkolla vijojnë mësimet edhe paralelet e tjera, kishte me qenë mirë që drejtori i DKA-së të na shpjegoj pse është mare ky vendim, dhe çfarë mendimi ka ai rreth këtyre vërejtjeve. Çështja e dytë ka të bëjë rreth ndërtesës së banimit kolektiv e cila ndodhet përball Teçes së Madhe, para një muaji nga moti i keqe është dëmtuar çatia e këtij objekti ku ka rënë një pjesë e çatis poshtë, por për fat të mirë nuk ka pasur dëme, deri sot nuk janë ndërmarrë kurrfarë masash për rregullimin e kësaj çatie. Pastaj çatia e këtij objekti kur është ndërtuar gjysma është e mbuluar me llamarinë dhe gjysma është terasë, sa e di unë edhe terasa ka qenë pjesë e projektit që të mbulohet, por në atë kohë kjo nuk është rregulluar, por vetëm pjesa e çatisë. Kërkoj nga drejtorët përkatës të më japin një shpjegim rreth këtyre pyetjeve të parashtruara.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për ët gjithë të pranishmit, këtë e kam kërkuar edhe më herët por po e përsërisë edhe një herë, banorët e fshatit Brestoc te rruga Diturisë kërkojnë nga komuna që së paku të dërgojnë një bager për të pastruar prockën e cila është duke ju shkakuar shumë probleme, arsyeja është se

ajo proçkë është mbushur me mbeturina dhe vetëm një rrjedh e vogël e ujit është duke i shkaktuar shumë telashe ku është duke dalë nga shtrati dhe uji depërton nëpër shtëpi që janë afër kësaj proçke. Po ashtu para disa dite kam kaluar në rrugën Zoqishtë – Retij, rruga ishte e mbushur me rërë dhe ishte e njëjtë sikurse të kalosh nëpër rrugë fushore, kishte me qenë mirë që kjo rrugë të pastrohet.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të bëjë dy pyetje sa i takon DKA-së, pyetja parë shkon rreth furnizimit me tekste shkollore për nxënës të klasave të shtata, ne kemi mungesë të teksteve shkollore gjegjësisht të gjuhës angleze për klasën e shtatë, kjo gjeneratë është e përfshirë në kurikulën e re, ku na është ndryshuar i gjithë plani kurse tekstet shkollore mungojnë, prandaj ne nuk duhet të presim suksese dhe rezultate kur nuk i ofrojmë profesorëve dhe nxënësve kushtet bazike dhe themelore siç janë tekstet. Prandaj ne arsimtarët realisht punojmë diçka tjetër dhe shkruajmë diçka tjetër, prandaj ne kërkojmë nga drejtorja e DKA-së që të bëjë trysni në Ministrinë e Arsimit. Pyetje tjetër ka të bëjë rreth tre pagave për arsimtarët që dalin në pension, kam dëgjuar se është marr një vendim që të paguhen këto tre paga, prandaj pyetje ime është a i ka marrë dikush këto tre paga pas pensionimit.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, a keni ndonjë informatë se për çka do të përdoret hapësira e shkollës së vjetër, tashmë objekti i rrënuar në fshatin Ratkoc.

Ali Zhuniqi – Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, e kam parë që në Fortesë është në vazhdim projekti për rregullimin e shtratit të lumit, sipas disa informatave që i kam marr nga terreni punimet janë ndërprerë, nëse kjo është e vërtetë cila është arsyeshmëria e ndërprerjes së punimeve, ndërsa nëse janë duke vazhduar punimet kur do të përfundoj ky projekt. Shqetësimi tjetër është i nderuari z. Kryesues ju jeni duke frekuentuar rrugën Fortesë – Celinë, njëra nga urat e cila është ndërtuar nga qeverisja e kaluar shkakton një problem të jashtëzakonshëm, pasi që kjo rrugë mjaftë frekuentohet dhe në atë pjesë ka një fashitje të tokës, pyetje ime është: A do të ndërmerrni diçka rreth rregullimit të kësaj ure sepse është duke paraqitur probleme për qytetarë.

Kryesuesi – Ju faleminderit për pyetjet e parashtruara, nëse ka ndonjëri nga drejtorët përgjigje tani mundet të dele që të ju përgjigjet, nëse jo mundet edhe në mbledhje e ardhshme të ju jepe përgjigje kuvendarëve.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, I nderuari z. Rexhep Oruçi siç e dini unë e kam thirrur një takim ku kemi bashkëbiseduar, ku anëtarët e komisionit më kanë autorizuar që së bashku me zyrën ligjore me i ndjekë procedurat sipas ligjit në fuqi, kemi qenë 3 herë në takim në Prishtinë në zyrën e Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, njësia për monitorimin e ndërmarrjeve lokale, ata nuk kanë mundur të na japin sqarim ligjorë për arsye se stacioni i autobusëve në Rahovec ka obligime dhe është specifik në krahasim me stacionet e tjera për arsye se ka shumë pak të hyra. Kam kërkuar që për muajin e ardhshëm të bëhet një raport detal, ku besoj se në mbledhjen e ardhshme do ju dorëzohet edhe juve, ku pastaj do të shikojmë se çfarë masash do të marrim, a do të vazhdojmë më tutje sipas ligjit për ta siguruar të gjithë stafin dhe me e marr stacionin e autobusëve si aset komunal, ose do të shikojmë ndonjë mundësi tjetër, por komuna e Rahovecit ndoshta për arsye të borxheve që i ka kjo ndërmarrje nuk ka mundësi që ta bëjë pjesë të komunës. Sa i përket pyetjes që e parashtroni z. Afrim Berisha, i nderuari së pari për këtë duhet që të njoftohet drejtori i DKA-së, sepse ajo pronë është nën kompetencën e asaj drejtorie, pastaj ne së bashku me drejtorin e DKA-së do të shikojmë nëse është mundësia që të zhvendosim murin që është rreth shkollës dhe pastaj të ndërtohet një parking i ri. Por së pasi kishte me qenë mirë këshilli i prindërve të i drejtohet drejtorisë së DKA-së, dhe ata pastaj të ju japim juve një përgjigje se a ka mundësi apo nuk ka mundësi që të krijohet një parking brenda oborrit të shkollës. I nderuari z. Masar Popaj pyeti rreth kanalit Sopniq – Fortesë, i nderuari kishte me qenë mirë që të ju drejtoheni drejtorit të urbanizimit i cili vije nga fshati i juaj sepse kjo është kompetencë e drejtorisë së tij. Z. Fehmi Cena pyeti për Ndërtesën kolektive, i nderuari tani me rregulloren e re ndërtesat janë nën kompetencën banorëve të cilët banojnë aty, është e vërtetë se komuna më parë ka intervenuar në sanimin e kulmit, edhe tani drejtorja e urbanizimit e ka një projekt për fasadimin e objekteve, por sa i përket çështjes së kulmit dhe sanimeve të tjera tani është kompetencë e vetë banorëve që jetojnë aty. Ne e kemi intervenuar në sanimin e atij kulmoi me aq mundësi sa kemi pasur, mirëpo ne nuk kemi kod të

veçantë që do na autorizojë si komunë në sanimin apo ndërrimin e kulmeve në banesat kolektive. E nderuara znj. Florida Bajraktari ne e kemi futë në buxhetin e vitit 2019 kërkesat e banorëve të fshatit Brestoc për ndërtimin e kanalizimeve, kurse sa i përket çështjes së kanalit do të shikojmë sepse kërkohet një buxhet më i madh sepse nuk është vetëm kanali i Brestocit, por vazhdon nga Brestoci dhe përfundon në Krushë të Madhe, por ne jemi duke shikuar mundësitë se çka mundemi të bëjmë për ndërtimin e këtij kanali. I nderuari z. Ali Zhuniqi pyeti rreth lumit në Fortesë, prapë. Po e them kishte me qenë mirë që këtë pyetje të ja bëni drejtorit të urbanizimit sepse është kompetencë e tyre. Kurse sa i përket rrugës Fortesë - Celinë është e vërtet se një pjesë e kësaj rruge është shembur për shkak të ujërave nëntokësor që vazhdimisht rrjedhin aty, ne e kemi një kontratë për rregullimin dhe sanimin e rrugëve dhe gropave, ne e kemi autorizuar kompaninë që të kujdeset për atë rrugë, ne do të shikojmë nëse mundemi këtë vite ta e rregullojmë këtë pjesë, po ashtu edhe urën e cila gjendet po në këtë rrugë.

Avni Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do mundohem që të i përgjigjem pyetjeve të cilët u parashtruan për drejtorin të cilën unë e udhëheqë. I nderuari z. Faton Ramadani është e vërtet që në disa shkolla 3-4, gjendja e njeve sanitare nuk është në nivel dhe ka nevojë që të intervenohet në mirëmbajtjen e tyre dhe përkujdesjen e tyre, por i nderuar gjendja nuk është e tillë siç e ka paraqitë kryetari i këshillit të prindërve i cili ka deklaruar se 20 shkolla nga 30 që i kemi janë me nje sanitare jo funksionale. Por të thuhet kjo atëherë i bie që ato janë jashtë përdorimit dhe kjo nuk është aspak e vërtet, e di saktë se si është gjendja e njeve sanitare nëpër shkolla. ishte një pyetje nga znj. Florije Boshnjaku se me cilin buxhet ndërtohet çerdhja në Rahovec Tulipanët, e nderuar kjo çerdhe është duke u ndërtuar me buxhetin e MASHT-it dhe Bankës Botërore, sa i përket afatit se kur do të përfundoj kjo çerdhe do ju njoftoj sapa të marr informata, ne kemi pak qasje në këtë projekt sepse nuk është projekt i komunës. Sa i përket ekskursionit të maturanëve i nderuari z. Fehmi Cena, ndoshta jemi vonuar pak sepse është dashur që ti dërgojmë pak më herët e jo në fund të muajit shtator, nuk i kam dërguar në ekskursion asnjë shkollë deri sa nuk më kanë ardhur të gjitha kërkesat nga katër gjimnazet. I nderuar këto kërkesa kanë qenë në emër të këshillave drejtues të shkollave, ku bëjnë pjesë këshilli i profesorëve, këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve, ne si drejtori kemi qenë në vizitë në objektet ku kanë banuar maturanët, maturanët kanë kaluar shkëlqyeshëm, ne nuk kemi pasur asnjë ankesë as nga nxënësit, as nga prindërit por as nga këshillat drejtues të shkollave. Është e kuptueshme se nëse nxënësit maturanë e pinë duhanin tek shpija ndoshta edhe atje e kanë pirë fshehurazi, por në objektet ku kanë banuar ata nuk është lejuar pirja e duhanit, edhe sikur të i lejonim ne stafi i hotelit nuk do i lejonte. Pasi ka përfunduar ekskursioni procesi mësimor është kthyer normales, ne kemi kërkuar raportet nga shkolla për mënyrën se si kanë kaluar në ekskursion dhe raportet janë shumë pozitive. Ne si DKA po ashtu kemi bërë edhe një sondazh me nxënësit e katër shkollave dhe të gjitha sondazhet tregojnë se kanë kaluar shumë mirë dhe ne asnjë ankesë nuk kemi nga askush. Kurse sa i takon mbylljes së shkollave në kohën kur maturanët kanë qenë në ekskursion, këtë vendim e kemi marrë ne si DKA, për arsye se një pjesë e mësimdhënësve kanë qenë të angazhuar në ekskursion, që mos të krijohet një situatë kaotike dhe sikur do të mbajë mësim dikush jo ne e kemi marrë këtë vendim. Por ato ditë të humbura do të zëvendësohen, zëvendësimi vetëm ka filluar të zbatohet. E nderuara znj. Mirjeta Krasniqi pyeti rreth mungesës së teksteve shkollore të gjuhës angleze për klasën e shtatë, pajtohëm me ju që teksteve e gjuhës angleze për klasat e shtata nuk kanë ardhur arsyeja është sepse nuk ka pasur libra të botuar për klasën e shtatë, sikurse për teksteve e tjera njëjtë edhe për këtë një herë bëhen plan programet pastaj botohen librat, ne kemi pasur mungesë edhe me teksteve e gjuhës gjermane por ato më vonë në kanë ardhur, por jo aq sa duhet edhe këtu kemi mungesë të teksteve. I gjithë defekti këtu është tek MASHT-i të cilët nuk kanë bërë planifikimin e duhur që në bazë të numri të nxënësve të bëjnë edhe botimin e teksteve të lëndëve të gjuhëve të huaja. Kurse sa i përket tre pagave pas pensionimit të mësimdhënësve, e nderuar askush nuk i ka marrë deri më tani, kjo është paraparë me qarkoren buxhetore nr.2, dhe nga janari i vitit 2019 do të fillohet që të aplikohet kjo pagesë nga MF, të gjitha ata që janë pensionuar nga viti 2015 do ti marrin nga tri paga përcjellëse pas pensionimit.

Faton Ramadani Drejtori nuk u përgjigj në pyetjen të cilën ja parashtrova, po ashtu mendoj si i pari i arsimit nuk duhet në këtë formë ta injorojë këshillin e prindërve sepse edhe ashtu ne mësimdhënësit vazhdimisht thirrëmi në atë se kemi mungesë të pranisë së prindërve në këshilla, prandaj mendoj se vërejtjet dhe këshillat e tyre duhet të pranohen dhe të analizohen mirë. Këshilli i prindërve ka dalë me fakte dhe foto për të gjitha shkollat, ne të gjithë jemi dëshmitar të imazheve të fotove të vrazhda, prandaj nuk mundet të thuhet se ajo gjendje është në 3-4 shkolla, pyetje ime ishte cilat masa janë ndërmarrë nga ana e DKA-së.

Fehmi Cena – Drejtori i shërbimeve publike nuk e dha sqarimin e plotë rreth pyetjes që ja bëra, projekti që ka qenë për ndërtimin e atij kulmi, e cekta se gjysma është e mbuluar me llamarinë dhe gjysme është terasë, në pjesën e terasës nuk është punuar asgjë, mua më intereson a ka qenë edhe kjo pjesë e ndërtimit së bashku me çatinë, pastaj atë që e thatë se tani e tutje banorët e kanë për detyrë rregullimin e çatisë, dua ta në cilën rregullore bazoheni, nëse mendoni në bazë të rregullores që ne sot e kemi si pikë të rendit të ditës, i nderuar kjo rregullore ende nuk ka kaluar dhe ende qëndron në fuqi e vjetra.

Afërdita Thaqi - A ka ndonjë konfirmim nga KQZ-ja rreth dorëheqjes nga kuvendit znj. Bjondina Kleqka, tani e emëruar Drejtoresh e Kulturës, Rinisë dhe sportit, pasi që e dimë se KQZ-ja nuk është funksionale për momentin. Po ashtu a do të ndërmerr komuna diçka rreth punëtorit të komunës z. Nysret Shala pasi që ai e ka pranuar fajësinë.

Kryesuesi – I falënderoj drejtorët për përgjigjet e dhënë, përgjigjet tjera do i merrni në mbledhjen e radhës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal për periudhën janar – shtator 2018.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtori Limani prezantoi Raportin Financiar janar – shtator 2018, para anëtarëve të kuvendit, ku cekta se ky raport përbëhet nga dy pjesë, pjesa e të hyrave dhe pjesa e shpenzimit të buxhetit. Drejtori Limani cekta të hyrat e realizuara sipas muajve ku për periudhën 9 mujore realizimi i të hyrave ishte 683,750.00 €, ku ka një ndryshim pozitiv me vitin e kaluar. Drejtori limani cekta realizimin e të hyrave sipas gjobave të gjykatave dhe trafikut, ku në periudhën 9 mujore realizimi i gjobave në trafik është 94,000.00 €, po ashtu edhe këtu kemi një ndryshim pozitiv në krahasim me vitin e kaluar, kurse realizimi i gjoba nga gjykatat këtë 9 mujor janë 15,639.00 €, por duke e ditur se raporti 3 mujor nga gjykatat nuk është i përfshirë në këtë raport. Kurse shpenzimi i buxhetit për këtë 9 mujor të vitit 2018 është në masën prej 8,740,882.00 €, që në përqindje i bie 63.81 % buxheti i shpenzuar për këto 9 muaj. Po ashtu drejtori Limani prezantoi se në fund të raportit e ka bashkangjitur edhe një raport nga zyra e prokurimit, ku janë të cekura të gjitha aktivitetet në kuadër të zyrës së prokurimit.

Fehmi Cena – Falënderoj drejtorin Limani për këtë prezantim të Raportit financiar janar – shtator 2018, rreth të hyrave dhe shpenzimeve të kësaj periudhe, ky raport është gjithëpërfshirës dhe shumë i qartë për ne. Faqe nr.4 tek të hyrat e planifikuara dhe të realizuara, drejtori e cekta se planifikimi ka qenë mbi 1,650,000.0 €, kurse të realizuara janë diku rreth 683,750.00 €, nëse e kthejmë në përqindje i bie diku rreth 41.4%, nëse e krahasojmë me vitin 2017 ka një rritje por kjo rritje nuk është shumë e madhe. Kurse realizimi në krahasim me planifikimin nuk është premtues për arsye se nuk është as 50% i asaj që do të duhet të ishte. Kurse tek krahasimi i të hyrave krahasuar me gjobat në trafik dhe gjobat nga gjykata, tek gjobat në trafik kemi një rritje dhe kjo është për tu përshëndetur, kurse tek të hyrat e gjykatave në krahasim me vitin 2017 kemi një rrënjë, dhe kishte me qenë mirë që të kemi një sqarim rreth kësaj, pra ku qëndron problemi a ka pasur gjoba më pak apo vije në shprehje efikasiteti i këtyre organeve. Ne si qytetar dhe kuvendarë e vlerësojmë pozicionin e të hyrave nga gjykatat si pjesë shumë të rëndësishme sepse sa më shumë të hyra atëherë efikasiteti i punës është më i mirë, kurse tek gjykatat në këtë rast është e kundërta.

Tek krahasimi i të hyrave sipas kodeve ekonomike janë disa gabime tek përqindja tek të hyrat në shëndetësi, të cilën duhet ta përmirësoni. Po ashtu edhe paraqitja grafike e të hyrave është një kontrast të madh njëra me tjetrën, sepse sipas këtij grafiti të hyrat e vitit 2018 janë dyfish më tepër se të vitit 2017, kurse në realitet sipas numrave nuk është ashtu, prandaj figurat grafike duhet të përputhen me shumën të hollave. Mendoj se

ata që mirën me këto grafika duhet të jenë tamam profesional dhe të paraqesin ashtu siç është dhe si duhet. Paraqitja mujore e të hyrave muajt më të suksesshëm që kanë pasur të hyrat më shumë viti 2018 mungon, besoj se kur të prezantohet raporti vjetor do të kemi të paraqitura këto të dhëna. Kurse tek shpenzimet sipas programeve, janë të paraqitura shpenzimet për paga, mëditje, mallra dhe shërbime, mendoj se do të ishte mirë që të jetë edhe pjesa e planifikuar për këtë periudhë, në mënyrë që ne me e ditë se shpenzimet sa janë bërë në krahasim me planifikimet, sepse kështu ne informohemi për shpenzimet por nuk e dimë se a ka shkuar gjithçka sipas planit apo jo. Tek shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve sipas programeve, në përgjithësi tek këto tabelat shpenzimet ajo që na bije në sy është rritja e shpenzimeve në të gjitha dikasteret në krahasim me vitin 2017, duke filluar nga zyra e kryetarit e tjerë. Por kur jemi tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve mendoj se është një pozicion ku qeveria lokale duhet që të shikojë të kursej sa më shumë buxhetin për arsye se këto janë punët që kryhen dhe avullohen, e diçka tjetër është kur shpenzohet për investime kapitale sepse ai projekt do të shërbej për një kohë të gjatë ndërsa tek shërbimet dhe mallrat është krejt diçka tjetër. Prandaj puna e juaj vlerësohet nga ana e jonë nëse e keni edhe pjesën e kursimit, dhe pikërisht aty ku duhet të ketë kursime nuk është duke u bërë.

Florije Boshnjaku – Falënderoj drejtorin e financave z. Afrim Limani që na ka sjellë një raport mjaft të detajuar, ku janë të paraqitura të dhënat e duhura, ka mundësi që të ketë disa gabime teknike por edhe ato gabime teknike plotësisht pajtohem që të përmirësohen sepse ky është një dokument zyrtar. E kam cekë edhe në KPF se këto raporte financiare janë duke na ardhur pak me vonesë për arsye se është një procedurë ligjore ku një herë shkon në Ministrinë e Financave dhe pastaj vije tek ne në kuvend. Tek plani vjetor i të hyrave për vitin 2018 pajtohem me z. Fehmi Cena, por ne që kemi qenë anëtar edhe më parë të kuvendit, kur janë planifikuar të hyrat nga ish qeveria jo që ata e kanë bërë planifikimin gabimisht, por këtë e ka obliguar MF që të parashihen të hyrat mbi 1,650,000.00 €, ne e kemi cekur në kuvend se këto të hyra nuk ka kurrfarë mundësie që të realizohen, prandaj mendoj se kjo ka ndikuar pozitivisht dhe këtë vit minus 400,000.00 € janë të hyrat vetanake. Kurse të hyrat që janë realizuar nuk është një shumë e madhe mirëpo ky është një hapë pozitiv sado që të jetë i vogël shpresoj se në të ardhmen me një angazhim sa më të madh të realizohen të hyrat vetanake edhe më shumë. I nderuari drejtor edhe në KPF e kamë cekur dhe kam kërkuar që tek gjobat nga gjykata për kuvend të ketë një sqarim sepse për tre muajt e fundit nuk i kemi të paraqitura gjobat nga gjykata, sepse po të ishin edhe për tre muaj besoj se do të barazoheshim. Po ashtu kam një kërkesë që neve si grupe jo formal i grave të na ndahen 20-30 litra derivate në muaj për takimet që do i mbajmë dhe angazhimet jashtë komunës sonë, kjo do na lehtësoj punën që mos të shkojmë ne nëpër zyrat e drejtorëve që ti kërkojmë kuponë për derivate por të i kemi tonat. Tek participimi i mësimi joformal, kur i ka paraqitur propozimin ish qeveria komunale, ne si kuvend kemi propozuar 11,000.00 € të jenë nga të hyrat e komunës, por kjo nuk ka mundur që të realizohet me arsyetimin se tek rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba nuk ka qenë e paraparë, dhe për këtë arsye mbajtja e mësimi jo formalë nuk mundet të mbahet, prandaj kisha kërkuar që kur të silllet rregullorja të shtohet edhe ky kod në mënyrë që të filloj që të realizohet ky projekt i cili ka mbetur peng.

Dervish Çadraku – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, sa i takon materialit e përgëzoi drejtorin z. Afrim Limani, është një material gjithëpërfshirës po ashtu ka të dhëna të mjaftueshme për të kuptuar ne se si qëndron puna me gjendjen në komunë. Kam disa vërejtjet e mija në dy shtylla tek parashikimi i buxhetit ose projektimi i buxhetit dhe tek shpenzimet, për të parën e kam përshtypjen se drejtorët e këtij legjislacioni ose e kanë mungesën e përvojës ose janë tepër entuziastë dhe nuk ja kanë qëlluar fortë në parashikimet e buxhetit, unë e them se janë shumë entuziastë dhe nuk e kanë përvojën e mjaftueshme sepse nëse e shikojmë dallimin në mes asaj që e kanë paraparë dhe asaj që është realizuar është një dallim i madh. Për të gjithë këto që i thash po dua të ju argumentoj, e kanë planifikuar më shumë se 1,650,000.00 €, kurse e kanë realizuar diku rreth 683,750.00 €, kanë mbetur edhe 3 muaj deri në fund të vitit nuk e di se si do e mbërrin shumën e planifikuar. Kurse të hyrat vetanake të realizuara për vitin 2017 nëse i krahasojmë me vitin 2018 janë planifikuar 1,237,520.00 €, kurse të realizuara janë 683,000.00 €. Kjo që e thash e dëshmon edhe kjo

tek kodi 50016, ku janë planifikuar 20,000./00 € kurse janë realizuar 858.00 €, pastaj kodi 50102 këtu janë planifikuar 120,000.00 € kurse janë realizuar vetëm 15,000.00 €, kodi 50201 aktivitetet individuale dhe të lira janë planifikuar 400,000.00 €, kurse janë realizuar vetëm 622.00 €, a është e saktë kjo apo është ndonjë gabim teknik. Kodi 50205 licencat e pranimit teknik të lokaleve e kenë paraparë një shumë simbolike, ju a parashihni që të hapni lokale të reja në komunën tonë apo siç është duke u parë do të shkojmë të gjithë në Gjermani dhe Zvicër dhe të i mbyllim edhe këto që i kemi. Prandaj kisha pasur dëshirë që drejtorët të jenë pak më të saktë në planifikime sepse nëse e shikon në fillim mendon se do na bëjë zoti çirak, por kur vije puna në fund dalim në deficit. Sa i takon shpenzimeve nëse i krahasojmë me vitet e kaluara pa dashtë askënd ta lavdëroj, por është një dallim në shpenzime me vitin e kaluar, nëse e bëjmë një krahasim tek kodi i shpenzimeve tek zyra e kryetarit kemi 15,000.00 € në vitin 2017, kurse 32,000.00 € kemi 2018, pastaj tek drejtorja e inspektoratit i ke 6,000.00 € kurse tani i ke 12,000.00 €, në total i kemi 93,488.00 € në vitin 2017, kurse tani deri në këtë periudhë i kemi 152,378.00 €, është një dallim goxha i madh. Nëse i shikojmë të gjitha drejtoritë një nga një do e shohim se ka një dallim në shpenzime nga viti i kaluar, mendoj se duhet të kihet kujdes sepse ne tani jemi në një situatë të një krize ekonomike, sepse para publike është përgjegjësi e të gjithë neve që jemi këtu. Në fund e kam edhe një vërejtje materialet që po na shpërndani për kuvend nuk jeni duke na i dhënë komplet gjithmonë, por kohë pas kohe jeni duke i plotësuar, kishte me qenë mirë që të na sillni me kohë sepse ne duhet të kemi kohë të mjaftueshme për me e përpunuar materialin.

Ali Zhuniqi – Për që ka një rritje të ndjeshme nëse e llogaritim në total lirishtë mundë të themi se ka rritje, pasi u tha shumë çka unë do bazohem në një krahasim duke u bazuar në periudhën janar – shtator tek mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, duke i përfshirë QKMF-në, shërbimet sociale, drejtorin e kulturës rini dhe sportit dhe drejtorin e arsimit. Në total riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve në total na jap një kosto prej 33,037.00 €, kurse nëse e shikojmë kodin buxhetor për furnizimin e qëndresë së mjekësisë familjare kemi diku furnizime mjekësore rreth 8,118.00 €. Kjo nuk më duket aspak serioze sepse të gjitha këto shpenzime të investohen në riparim të automjeteve, kurse në anën tjetër furnizimet mjekësore të cilat janë bazë për qytetarët nuk ndermirret asnjë hapë. Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore na jep një shpenzim prej 31,528.00 €, prapë nëse e krahasojmë me furnizime mjekësore paraqet një dallim jashtëzakonisht të madh. Po ashtu edhe tek furnizimi me ushqim dhe pije nëse e llogaritim totalin janar – shtator, na jep një vlerë diku rreth 11,600.00 €, këto shpenzime nuk e arsyetojnë paraqitjen në këtë tabelë.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket raportit financiar për këtë 9 muhor të vitit 2018, nuk isha lëshuar shumë të diskutoj, tashmë po dihet që kemi një rritje të ndjeshme të të hyra, pastaj sa i përket shpenzimeve buxhetore pothuajse të njëjtat vërejtje janë duke u dhënë edhe në raportin 3 muhor, raportin 6 muhor si dhe tash në raportin 9 muhor. Ajo që mua më intereson dhe që kisha dashtë të kemi informatë është tek lista e projekteve kapitale e cila është e paraqitur këtu, disa projekte i kanë mjetet e planifikuara, kurse disa nga ta kanë qenë të planifikuara me buxhet të vitit 2018 por procedurat tenderuese nuk anë filluar ende, a planifikohet që këto projekte të fillojnë brenda këtij viti apo do të shtyhen për vitin e ardhshëm.

Trajko Shaqriq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kam një vërejtje sa i përket raportit për ZKK-në, ku janë paraparë shpenzimet për këtë zyre, janë të cekuar shpenzimet për automjete, ne e dimë që kjo zyre nuk a automjet të vetin, ushtruesi i detyrës së kësaj zyre të gjitha punët i kryen me automjetin e tij privat. Po ashtu jam duke parë edhe një shumë të konsiderueshme të shpenzimeve sa i përket drekave zyrtare, kurse kjo zyre nuk ka bërë asnjë shpenzim për dreka zyrtare.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ajo që do diskutoj unë është qysh në fillim më ra në sy janë të hyrat nga drejtorja e inspektoratit, këtu jemi duke parë që për nëntë muaj të këtij viti nuk ka asnjë gjobë të shqiptuar nga kjo drejtori, kurse në anën tjetër kjo drejtori ka shpenzuar mjete të konsiderueshme për zhvillimin e aktiviteteve të tyre në territorin e komunës së Rahovecit. Pyetje ime për drejtorin e inspektoratit është: A do të kemi një planë në mënyrë që këta inspektor të i kryejnë punët e tyre apo do të presim sikurse tani që gati një vit ka kaluar dhe ende nuk ka asnjë gjobë nga këta inspektor. Kurse

në anën tjetër si të dalim në qytet i kemi trotuaret të gjitha të uzurpuara nga mallrat që i ekspozojnë lokalet, pastaj nga hoteloritë shfrytëzohen hapësirat pa kurrfarë kriteri, këmbësorët nuk kanë as ku të kalojnë nga ekspozimi i mallrave në trotuare, kurse në anën tjetër kemi një plogështi të plotë nga kjo drejtori në teren. Sa i përket të hyrave nga drejtorja për shëndetësi, kemi një rrënjë në krahasim me vitin 2017, por këtu nuk është i cekur numri i pacienteve sepse atëherë do të kishim një tregues shumë më të saktë se cila ka qenë performanca e kësaj drejtorie në inkasimin e mjeteve. Por sikurse raporti 3 mujor, 6 mujor edhe ky 9 mujor, gjithmonë jemi duke parë që ka një rrënjë të inkasimit të mjeteve nga kjo drejtori, prandaj uroj që kjo të përmirësohet në të ardhmen dhe të ritet performanca e punës në këto sektorë.

Afrim Limani – Falënderoj të gjithë kuvendarët për pyetjet që mi kanë bërë, do ja filloj një nga një për tu përgjigjur pyetjeve të parashtruara. I nderuari z. Fehmi Cena fillimisht do i marrim parasysh gabimet teknike që janë bërë në këtë raport, besoj se në të ardhmen nuk do të përsëriten. I nderuar ke pyetur pse mungojnë të dhënat nga tatimi në pronë për vitin 2018, i nderuar arsyeja pse mungojnë është sepse ende nuk është mbyllur viti fiskal, dhe ne zakonisht raportin e japim pasi të mbyllet viti fiskal, pastaj ne aty e vërejmë se cili muaj ka qenë më i suksesshëm, prandaj i nderuar në raportin e fundit të vitit besoj se do i kesh edhe këto të dhëna. Sa i përket të hyrave nga gjobat e gjykatave për këtë periudhë, i nderuar gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut janë gjobat tek të cilat ne nuk mundemi të ndikojmë, sepse ato konsiderohen edhe si të hyrat e jashtëzakonshme. Gjobat e gjykatave janë pjesa më e madhe e dënimeve në komunikacion, nëse i mbledhim të hyrat nga raportet e kaluar dhe të hyrat e këtij tre mujori që janë në Ministrinë e Drejtësisë e cila shumë shpejtë do na dërgojë një raport, por të hyrat në total janë me një diferencë prej 41,000.00 €. Tek pjesa planifikimit dhe realizimit të buxhetit në përqindje, tek planifikimi i të hyrave ne si komunë nuk mundemi që të ndikojmë tek të gjitha llojet të hyrave sepse edhe limitin e totalit të hyrave shumë herë na cakton ministria. Është rregull dhe standard që krahasimi i të hyrave të bëhet gjithmonë me vitin paraprak, ne në raport me vitin paraprak kemi një ndryshim pozitiv. Ishte edhe një pyetje pse kemi rritje të shpenzimeve, buxheti i komunës së Rahovecit si organizatë buxhetore e ka buxhetin e planifikuar në detale për secilën kategori, qëllimi ynë është që këtë buxhet ta realizojmë me masën e planifikimit, kjo përgjigje vlen edhe për z. Dervish Çadraku. Procesi i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë 9 mujore për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është në masën prej 35%, realisht i bie që nuk është i mirë, por mendoj se është koha e mjaftueshme që shpenzimi i buxhetit për këtë kategori ta bëjmë në masën 100%. E nderuara znj. Florije, të hyrat e larta janë të caktuara nga Ministria e Financave dhe realisht për komunën tonë është i lartë dhe nuk po kemi mundësi që ta realizojmë. Kurse sa i përket participimit tek arsimit jo formal, sa kam informata DKA-ja e ka mare një udhëzim administrativ vitin e kaluar, me masën e asaj që të mbahet arsimit jo formal, dhe më parë është planifikuar një kategori e të hyrave nga kjo kategori me shumën mbi 11,000.00 €, kurse pse nuk ka filluar ende procesi, mendoj se për këtë më së mirë mundet që të përgjigjet drejtori i arsimit. I nderuari z. Dervish Çadraku i bëri disa pyetje, i nderuar për arsye të planifikimit të të hyrave nga MF, ne jemi detyruar që të bëjmë një rritje të planifikimit për secilën kategori, sa i përket çështjes së shpenzimit të buxhetit, qëllimi ynë është që sa më shumë të shpenzojmë këtë buxhet, por gjithmonë të jetë sipas planifikimit. I nderuari z. Ali Zhuniqi e konsideroj se çdo shpenzim për mirëmbajtjen e automjeteve për këtë periudhë është brenda standardeve të lejuara, duke e ditur se e kemi një numër goxha të madh të veturave duke përfshirë edhe shëndetësinë, shëndetësia sipas informatave që i kam i ka diku rreth 12 vetura dhe 4 autoambulanca të cilat vazhdimisht janë në lëvizje dhe në qarkullim. Harrova të ju tregoj në fillim të prezantimit të këtij raporti, në faqe nr.15 e kam formuar edhe një shtyllë ku i kam cekur se sa kemi pasur obligime të bartura nga viti i kaluar, ku i kam ndarë dhe specifikuar. Po ashtu dikush e ceku se mirëmbajtja e objekteve shëndetësore është një shpenzim i lartë, ndoshta në bazë të kodeve e ke ngatërruar me ndonjë shpenzim tjetër, por mirëmbajtja e objekteve shëndetësore është marrëveshja të cilën e kemi me kompaninë e pastrimit, janë të gjitha pagat që ne i paguajmë për këtë kompani të pastrimit të objekteve shëndetësore. Sa i përket furnizimit me ushqim dhe pije besoj se jemi brenda limitit të lejuar, këto janë kryesisht shpenzimet të cilat janë krijuar më shumë për drejtorin e DKA-së, sepse kjo drejtori ka më

shumë aktivitete se të gjitha drejtorit, por kryesisht këto shpenzime janë shpenzime të ujit. I nderuari z. Ali Morina e bëri një pyetje në lidhje me listën e projekteve kapitale, i nderuar një raporte që e kam mare nga zyra e prokurimit, janë të përfshirë të gjitha kontratat të cilat janë bërë gjatë këtij viti, si data e kontratës, afati i kontratës etj, por ajo që i mungon është pjesa e buxhetit të shpenzuar, por besoj se në raportin e fundit të këtij viti do të përfshihen të gjitha. I nderuari z. Shariq, i nderuar edhe ZKK-ja është pjesë e organizatës sonë buxhetore, kjo zyre e ka një buxhet të caktuar dhe ai buxhet duhet që të shpenzohet edhe në këtë kategori, mundet të ndodhë që për një trajnim ta shfrytëzojnë makinat e komunës dhe ajo është evidentuar si shpenzim. Po ashtu mundet të ndodhë që aktualisht ne nuk kemi alukim të mjeteve në kategori tjera, atëherë deri sa është organizatë buxhetore e jona ne kemi mundësi që të ja marrim një shpenzim dhe të fusim në këtë kategori, po ashtu mundet të ndodhë që është krijuar një shpenzim por ne në fakte nuk e kemi evidentuar. I nderuar z. Munib Durguti, e dini edhe ju, drejtoria e inspektoratit ka të hyra por këto të hyra realizohen përmes gjykatave.

Kryesuesi – E qes në votim Raportin financiar të realizimit të buxhetit komunal për periudhën janar – shtator 2018: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tret (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft - rregullore për Shërbime Publike.

Përparim Krasniqi – Të nderuar siç e dini Draft Rregullorja për Shërbime Publike ka kaluar disa procedura, me vendim të kuvendit është kërkuar që të hidhet në debat publik kjo rregullore, kjo rregullore ka qëndruar në Web faqe të komunës për 15 ditë,, kurse me 18 shtator është mbajtur debati publik në sallën e kuvendit të komunës. Të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që kanë dalur nga debati dhe KPF-ja janë inkorporuar, kurse sot ka ardhur drafti final për tu aprovuar nga ana e juaj. Kjo rregullore ka një numër të madh nenesh të cilat i rregullon përgjegjësit dhe detyrat që dalin nga kjo rregullore, prandaj përmes juve kërkoj që kjo rregullore sot ta merë dritën jeshile dhe pastaj qytetarët e komunës sonë të kenë mundësi që ti aprovojnë të gjitha ato kërkesa që dalin nga kjo rregullore.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje për ët gjithë të pranishmit, këtë rregullore e kam përcjellë edhe gjatë diskutimit publik që ka qenë për ndryshim ose sugjerim ose vërejtje, kjo rregullore për mendimin tim vetëm nëse 30% arrihet që të realizohet atëherë është një sukses shumë i madh. Do diskutoj pak rreth kësaj rregullore, tek neni 67 firmat dhe reklammat, ka plotë firma dhe biznese të cilat nuk kanë marr fare leje për vendosjen e reklamave të tyre. Pastaj neni 97 paragrafi 1 cekë: Të gjitha rrugët duhet të kenë të shënuara në këndet e tyre tabelat me emërtimin e rrugëve, kurse ndërtesat dhe shtëpitë duhet të kenë numrat e tyre. Para dy mbledhjeve e kam bërë një kërkesë për formimin e një komisioni për emërtimin e rrugëve për arsye se ne kemi ende probleme me emërtim të rrugëve dhe me vënien e numrit të shtëpive, mendoj që së pari është dashur ta zgjidhim këtë problem, formimin e një komisioni për emërtim të rrugëve të di dimë rrugët saktë dhe pastaj të bëhet kjo rregullore, por edhe kjo nuk është vonë pasi u premtua nga kryesuesi i kuvendit se në mbledhjen e ardhshme do të vije si pikë e rendit të ditës. Sa i përket kësaj rregullore asgjë nuk kisha shtuar, vetëm kisha dashtë me ditë nga drejtori a e ka paraparë në këtë rregullore për biznese apo lokale leje për kuqje në rrugë publike, për arsye se edhe kjo paraqet të hyra financiare. Po ashtu tek gropimet sepse shumica e gropimeve bëhen edhe nga personat juridik, por edhe nga personat fizik, dhe këto gropime nuk mbyllen asnjëherë. Këto dënime që i ka paraparë në rregullore e thash edhe më herët se nëse arrihet vetëm 30% në rregull do jemi.

Mirjeta Krasniqi – Pyetje ime sa i përket kësaj rregullore është: Në cilat pika ose nene janë duke u bërë ndryshime në këtë rregullore nga rregullorja paraprake.

Florije Boshnjaku – Tek faqe nr.25 neni 131, vendosja e shportave dhe kontejnerëve, me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendosen shportat për mbeturina dhe kontejnerët për mbeturina, në numër të mjaftueshëm dhe ato i sigurojnë shfrytëzuesit. Për shporta nëpër familje kuptohet, por nëpër lagje dhe institucione ku janë kontejnerët, ato shporta e duhet që ti sigurojë lagjja apo duhet të i sigurojë kompania e cila e bënë bartjen e mbeturinave. Kishte me qenë mirë që kjo të jetë pak më e qartë

sepse pak është konfuzë dhe e pakuptueshme. Po ashtu tek neni 132 ceket: Bartja e mbeturinave në kllapa e ke konsultë, këto që janë në kllapa është mirë që të shlyhen sepse tani më nuk ke me kënd që të konsultohesh, kjo duhet të jetë përfundimtare. Po ashtu edhe tek neni 135 përsëri e ke në kllapa konsultë me rregulloren e vjetër, edhe kjo duhet që të shlyhet, tek neni 136 Ndërmarrja e autorizuar ceket: Bartjen e mbeturinave nga enët e caktuara për mbeturina (enët speciale dhe kontejnerët) e kryen ndërmarrja së cilës i besohen punët. Po ashtu edhe këtu mendoj se pjesa që është në kllapa duhet të hiqet sepse nuk lejohet, sepse kur është akt normativ duhet të largohen kllapat. Pastaj për çfarë enë speciale flitet këtu, a ka të bëjë me ndonjë mbeturin e veçantë, pastaj tek sanksionet kundërvajtësve zëvendësohen me gjobë sepse kështu është edhe me ligj për kundërvajtje.

Munib Durguti – Desha të i japë disa propozime për përmirësim të tekstit sa i përket kësaj rregullore, neni 54 tek sqarimi i hapësirave publike është përdorur një term jo edukat ku ceket: Sipërfaqet publike, sipas kësaj Rregulloreje, konsiderohen ato sipërfaqe, në të cilat është i lejuar aderimi,(qëndrimi) në numër të pakufizuar i personave, mendoj se termi aderim është i papërshtatshëm dhe kishte me qenë mirë që të zëvendësohet me termin si tubimi, grumbullimi etj. pastaj tek neni 59 Ndalimi i shitjeve në trotuare dhe sheshe, ku ceketj: Në sipërfaqet e trotuareve dhe të shesheve të vogla publike, nuk lejohet shitja dhe vendosja e gjësendeve për zhvillimin e ndonjë veprimtarie në mënyrë të pa autorizuar. Propozoj që ky nen të plotësohet dhe të trajtohet pak më shumë shfrytëzimi i këtyre trotuareve sepse këtu kemi të bëjmë edhe me hoteleri që i përmenda më parë, ku gati i kanë uzurpuar të gjithë pjesën publik për kalimin e këmbësorëve. Po ashtu këtu të cekem gjobat konkrete për ata që i shfrytëzojnë hapësirat publike pa autorizim ose leje. Pastaj tek neni 131 Vendosja e shportave dhe kontejnerëve tek pika 1 ceket: Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendosen shportat për mbeturina dhe kontejnerët për mbeturina, në numër të mjaftueshëm dhe ato i sigurojnë shfrytëzuesit. Për ne është shumë e paqartë kjo, kush janë shfrytëzuesit në këtë rast, nëse bëhet fjalë për qytetarët deri më tani nuk ka qenë praktik që vetë qytetarët të i blejnë kontejnerët, për derisa e kemi një kompani e cila është e angazhuar për mirëmbajtje pastrim dhe furnizim, për këtë kisha kërkuar një sqarim nga drejtori. Dhe në fund kur është paraqitur kjo rregullore për herë të parë në kuvend, neve na është premtuar nga kryetari i komunës së në këtë rregullore do të trajtohet edhe qetësia publike, ne në atë kohë kemi ngritë një shqetësim se qetësia publike në komunën tonë është një fushë e patrajtuar dhe ka ankesa të shpeshta nga qytetarët rreth kafiterive dhe hotelerive të cilët nuk i respektojnë oraret e tyre, po ashtu shpesh herë e shkelin ligjin duke lëshuar muzikë natën pas orës 23:00 ku kjo është e ndaluar me ligj. Kurse këtë problematik ne nuk jemi duke e parë fare të përfshirë në këtë rregullore.

Përparim Krasniqi – Ju falënderoj të gjithëve për pyetjet e parashtruara, po i përgjigjem z. Vahid Krasniqi, i nderuar sa i përket çështjeve të dënimeve ato janë të rregulluara me ligj dhe me gjoba mandatorë, po ashtu edhe tek gropimet janë të përcaktuara me rregulloren për taksa dhe tarifa, aty janë të përcaktuara të gjitha dhe për 1m² ajo kompani e cila e demolon rrugën e ka për detyrë të kthej në gjendje të mëparshme dhe duhet të bëjë pagesën për pëlqimin e asaj rruge që do të demolohej. Ishte një pyetje nga znj. Mirjeta Krasniqi a ka pasur ndryshime diçka nga rregullorja e vjetër, e nderuara ndryshimi është tek gjobat mandatorë për arsye se ka hyrë në fuqi edhe udhëzimi administrativ në fuqi për gjobat mandatore ku kjo kompetencë është bartur tek inspektorët komunal, po ashtu janë të harmonizuara me ligjet në fuqi, kjo pra është ndryshimi që na ka imponuar neve që të ndryshojmë këtë rregullore. E nderuara znj. Florije sa i përket çështjes së kontejnerëve, këtu është bërë një gabim teknik sepse për këtë është e obliguar kompania e cila e ka për detyrë të i merë mbeturinat. Po ashtu në të gjitha ato nene ku shkruan konsultë do të shlyhen sepse deri më tani ka qenë draft, kurse kur të votohet nga ana e juaj sekretariati i kuvendit i shlyen. I nderuar z. Munib Durguti, mendoj se ndoshta nuk është gabim fjala aderim por duhet të plotësohet vetëm edhe fjala dhe qëndrimi, ne tjetër termin për këtë çështje nuk kemi mundur të gjejmë, por sidoqoftë ne do i konsultojmë dhe propozimet e juaja dhe tonat dhe në fund do të dalim me një version përfundimtar . kurse sa i përket zhurmës ose zërimit që janë duke lëshuar kafiterit pas kohës së ndaluar, kam biseduar edhe me zyrën ligjore në mënyrë që të

gjejmë një zgjidhje, por sipas tyre duhet të bëhet një rregullore e veçantë e cila do e rregullojë çështjen e zhurmës dhe zërimit, përndryshe edhe në rregulloren e vjetër nuk ka qenë e specifikuar. Tani unë si drejtor e kam një propozim normalë nëse përkrahet edhe nga ju që të jetë pjesë e kësaj rregullore, kjo na ka ikur dhe nuk kemi mundur ta fusim në rregullore. Tek neni 5, kemi shumë kërkesa nga qytetarët sepse vazhdimisht kanë probleme me qasje në kanalizim sidomos tek bllokimet. Propozimi imë është që të shtohet edhe ky pika 1.6 ku ceket: Në rast të bllokimit të pusetes, kompania e autorizuar e ka për obligim që të bëjë deblokimin e pusetës dhe është e obliguar që të bëjë gërmimin dhe vendosjen e gypit të ri (hapja e kanalit, vendosja e gypit dhe mbulimi i gypit me zhavorr), prej pusetës deri në puset, në mënyrë që rrjeti i kanalizimit të jetë funksional. Sepse gjatë daljes në teren ne jemi duke hasur shumë në këso probleme sepse kompania po tërhiqet, prandaj në bazë të kësaj rregullore ne me kompaninë KRU- Gjakova do të bëjmë një marrëveshje paraprake ku do i specifikojmë të gjitha shqetësimet tona.

Kryesuesi – E qes në votim Draft - rregullores për Shërbime Publike, së bashku me propozimin e drejtorit që të shtohet tek neni 5 edhe pika 1.6, me arsyetimin që ai e dha: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi propozimit të Kryetarit që të i jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe.

Afrim Oruçi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, këtu kemi të bëjmë me pronë private në emër të pronarit z. Refki Fetah Hoti, sipas certifikate së pronësisë 01901/0, këtu bëhet fjalë për një pjesë të parcelës në sipërfaqe prej 1 ari 78 m². Të nderua kuvendarë/e këtu bëhet fjalë për shtëpinë ku ka ndodhur masakra më e madhe luftës së fundit në këtë regjion, në këtë shtëpi janë vrarë dhe pastaj të djegur diku rreth 20 persona, të cilët janë strehuar në kohë lufte. Gjithashtu vlen të ceket se kjo shtëpi e masakrës sipas gjykatës ndërkombëtare të Hagës për arsye të masakrës është mare si dëshmi dhe emërtuar si krimaterium, ne si drejtori i kemi zhvilluar tre takime me MMPH, saktësisht me departamentin e shpronësimit, kiu jemi munduar që ky departament ta merë përsipër këtë shtëpi, por ligji i shpronësimit nuk e lejon që të shpronësohet një pronë private e cila është brenda komunave të Kosovës, për faktin se kjo pjesë ose kjo shtëpi nuk është nën mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Andaj kemi vendosur që të kërkojmë nga ju që të na jepni pëlqimin për shpronësimin e kësaj parcele, ku neve të na lejohet pastaj që të vazhdojmë me procedurat e tjera sa i përket kësaj shtëpie, po ashtu pastaj ne do mundohemi që të kujdesemi që përmes MMPH dhe Qeverisë së Kosovës, ky objekt kur të restaurohet, konservohet dhe ruhet të hyjë në listën e objekteve që janë nën mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku mirëmbajtjen dhe shpenzimet e tjera do i merë ky agjencion. Ftojë kuvendarët që pas shqyrtimit ta përkrahin këtë propozim vendim të kryetarit të komunës.

Besnik F Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Do të ndërlihem me pikën e 5-të të rendit të ditës që ka të bëjë me çështjen e dhënies dhe pëlqimin për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin-restaurimin e Shtëpisë së Masakrës në Krushë të Madhe. Siç dihet në mars të vitit 1999, lufta për shqiptarët e Kosovës, posaçërisht për krushjanët ishte një ngjarje që do të mbetet përjetë e paharruar në kujtesën e atyre që arritën të dalin të gjallë nga ajo luftë. Me datën 25 dhe 26 mars të vitit 1999, ndodhi me e keqja për banorët e Krushes dhe fshatrave përreth. Forcat të mëdha ushtarake ia mësynë fshatit për të shfarosur popullatën. Qindra ushtarë të armatosur deri në dhëmbë, të udhëhequr nga eprorët e tyre, dogjën Krushën dhe fshatrat përreth shtëpi për shtëpi, nxorën banorët në rrugë duke i dërguar herë në një vend dhe herë në tjetrin, për të kërkuar vendin se ku ishte më mirë për t'i pushkatuar, masakruar e djege për së gjalli. Kështu u vranë dhe u masakruan 243 persona, 207 nga Krusha dhe 35 të tjerë të strehuar në fshat. Pas luftës, me 23 qershor të vitit '99 ish-ministri i jashtëm gjerman Joschka Fischer i shoqëruar nga ish-ministri i mbrojtjes Rudolph Schorping, pikërisht nga ky vend, nga shtëpia e tmerrit u shpreh, citoj: "Kjo vizitë në Krushë të Madhe sërish më qartësoi se për çka kishim luftuar dhe se kishim vepruar drejt me vendimin që Milosheviqin këtë herë ta konfrontonim ushtarakisht dhe me vendosmëri" mbylli citatin. Një ditë vonë me 24 qershor ish-ministri i jashtëm britanik Robin Cook, para shtëpisë së

tmerrit u shpreh, citoj “Nuk do ti mbyllim sytë para kësaj... Kjo është e tmerrshme. Jam tepër i prekur dhe i emocionuar nga kjo...jemi duke i ndjekur ata që kanë projektuar këto krime dhe fushatën sistematike të krimeve” mbylli citatin. Këto personalitete me ndikim, e mbrojtën fjalën e tyre. Nga dëshmitë e gjetura për masakrën e Krushës, Tribunali i Hagës bëri fajtor drejtpërsëdrejti regjimin e Millosheviqit dhe bashkëpunëtorët e tij si planifikues, nxitës, që urdhëruan përgatitjen dhe kryerjen e veprimeve siç janë: vrasje, dëbim, shkatërrim kulturor i objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë, krim kundër njerëzimit dhe shkelje e zakoneve të luftës. Të nderuar të pranishëm, Shtëpia Muze e masakrës është një mundësi unike për të njohur tmerrin që serbet ushtruan kundër civilëve të pafajshëm në Krushë. Mundësi unike për ta njohur opinionin vendor dhe ndërkombëtar për atë që ndodhi në Krushë. E përkrah pa rezervë këtë vendim në emër të kryetarit Smajl Latifi dhe kërkesës së banorëve të Krushës së Madhe, jam i gatshëm që të japë kontributin time në këtë drejtim, i ftoj të gjithë kolegët që ta votojnë këtë propozim.

Fehmi Cena – Ne këtë pikë e kemi shqyrtuar edhe në KPF, këtu kemi të bëjmë me ndërtimin dhe restaurimin e shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe, mendoj se ky do të jetë një projekt i cili do të bartë një pjesë të historisë sonë të dhimbshme, por njëkohësisht edhe të sakrificës, kjo shtëpi nuk do të jetë vetëm simbolikë e Krushës së Madhe por do të jetë simbolik e gjithë Komunes dhe gjithë Kosovës. Edhe ne si grupe i LDK-së i japim përkrahje të plotë këtij shpronësimi dhe ndërtimit të projektit, por edhe në mbledhje të KPF-së e kam pasur një kërkesë rreth emërtimit të kësaj shtëpie, ndoshta do të ishte më mirë që të emërtohet Shtëpia Muze e Masakrës së Krushës së Madhe, mendoj se kështu do ta ketë një kuptim pak më të plotë. Me siguri aty do të ketë edhe eksponate të tjera të cilat do të dëshmojnë për masakrën e madhe që e ka bërë okupatori serb ndaj popullit tonë, po ashtu edhe për sakrificën që ne e kemi bërë për lirinë tonë.

Florije Boshnjaku – Ne për shpronësim të kësaj prone kemi marr vendim qysh me 30 qershor 2017, edhe unë isha pajtuar me propozimin e juaj i nderuari z. Cena, por ne në vitin 2017 kur e kemi marr vendimin e kemi quajtur Ndërtimi i shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe, për tu ndryshuar ky emërtim ne duhet që të ndryshojmë edhe vendimin e marr me 30 qershor 2017. Po besoj se kjo nuk është problem i madh nëse pajtoheni ju ne mundemi ta ndryshojmë vendimin, ose mundemi që të konsultohemi me ekspertë të kësaj çështje dhe së shohim se çka na thonë ata.

Afrim Oruçi – Të nderuar sa i përket vendimit të vitit 2017 të cilin e përmendi znj. Florije Boshnjaku,, ky vendim të nderuar ka të bëjë me shpallje të interesit të përgjithshëm, kurse ne në këtë moment nga ju kemi duke kërkuar që të na jepni pëlqim për shpronësim. Vendimi që ju do ta votoni sot nuk ka të bëjë me emërtimin e kësaj shtëpie së masakrës, ky vendim përsëri do të kthehet tek ju dhe ju jeni ata që vendosni se si të emërtohet kjo shtëpi.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e Kryetarit që të i jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

Sali Sallteku - Përshëndetje për të gjithë, mendoj se nuk kemi edhe shumë për të diskutuar sa i përket kësaj mbledhje, sepse dikush kërkoi pauzë, besoni se e kryejmë shpejtë sepse sot nuk e kemi në mbledhje prezent kryetarin, e pash që në procesverbalin e kaluar gjysma e procesverbalit ishte nga diskutimi i tij. Po ashtu kam një lutje, nëse ka mundësi që përkthimi për kolegun z. Trajko Shariq të bëhet në mënyrë elektronike sepse me të vërtetë është duke penguar shumë. E di që ky e njuh gjuhen shqipe shumë mirë sikurse që unë që e njoh gjuhen serbe, prandaj le të ndahet një buxhet dhe le të rregullohet kjo punë.

6. Shqyrtimi dhe aprovimi propozimit të Kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës P- 71510031-00290-0, në fshatin Zatriq.

Afrim Oruçi – Ky propozim ka të bëjë me zonën kadastrale në fshatin Zatriq, pjesë e parcelës me nr.00290-0, me sipërfaqe prej 3 ari e 50m² nga sipërfaqja e përgjithshme. Këtu kemi të bëjmë me shpalljen e zonës me interes të veçantë të vend rrënjës së dëshmorëve, qëllimi i vetëm është ruajtja, rregullimi dhe mirëmbajtja e

vendit. Kjo parcelë është pronë shtetërore e Kosovës, shfrytëzues është ekonomia e pyjeve Rahovec. Kërkoj nga kuvendarët që pas shqyrtimit ta përkrahin dhe votojnë propozimin e kryetarit të komunës.

Sali Sallteku – Sa e di unë ky vend ku kanë rënë dëshmorët është rrethuar dhe kjo punë është e kryer dhe kjo pronë nuk është private, prandaj ne si grupe i PDK-së e përkrahim këtë propozim.

Dervish Çardaku – Mendoj se është duke u bërë një punë e mirë që janë duke u definuar pronat e vend rrënjës së dëshmorëve dhe vendet ku janë ngritur lapidarët për dëshmorë. E kam një propozim tjetër në lidhje me këtë temë, për arsye se gati në çdo mbledhje të kuvendit e kemi nga një pikë të rendit të ditës rreth kësaj teme, kishte me qenë mirë që kuvendi i komunës sonë të merë një vendim për të gjitha pronat që janë të kësaj kategorie, e jo në çdo mbledhje të marrim veç e veç. Sa i përket kësaj pike ne si grup i VV-së e përkrahim plotësisht.

Kryesuesi – E qes në aprovim propozimin e Kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës P- 71510031-00290-0, në fshatin Zatriq. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë (6) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit për Ridestinim të mjeteve në buxhetin e vitit 2018.

Afrim Limani – Në bazë të ligjit për financa publike dhe përgjegjësi janë dy procese të cilat zhvillohen për bartje të mjeteve vetanake rishikimi i buxhetit dhe ridestini i buxhetit. Rishikim të buxhetit siç e dini edhe ju për këtë vit nuk kemi pasur, kemi marrë sinjale edhe nga MF ku na është thënë se nuk a nevojë të bëhet rishikimi i buxhetit për arsye se nuk ka ndonjë tepicë të madhe të mjeteve nëpër organizatat e ndryshme buxhetore. Kurse mundësia e dytë është ridestini i buxhetit, ne si drejtori e financave e kemi marrë sinjalin që mundemi të fillojmë këtë proces, shuma e mjeteve për komunën tonë e cila duhet të ridestinohet është në vlerën prej 369,429.00 €. Këto projekt nuk kanë mundur të realizohen, dhe pse nuk kanë mundur të shfrytëzohen këto mjete besoj se secila drejtori i ka arsyet e veta dhe do ju shpjegojnë juve. E kam përgatitur një dokument për juve me një dizajnë krejt ndryshe, e kam bërë më të thjeshtë dhe më të kapshëm si për juve ashtu edhe për ne. Kërkoj nga ju që të votoni këtë pikë të rendit të ditës arsyeja është se edhe ashtu komuna jonë i ka disa vështirësi financiare, dhe nëse nuk kryhet edhe ky proces ato vështirësi do të thellohen dhe ne do të hymë edhe më shumë në obligime financiare.

Mirjeta Krasniqi – Sa i përket kësaj pike, të nderuar unë bëj pjesë edhe në Komitetin për Komunitete, konkretisht e kam fjalën tek ridestini i mjeteve nga ZKK-ja me shumë prej 12,269.00 €. Ne me datë 19.10.2018 e kemi pasur një mbledhje si Komitet për Komunitete dhe në atë takim na ka ardhur një kërkesë nga kryesuesi i këtij komiteti z. Bajram Morina për rregullimin e një salle të leximit në kuadër të shkollës fillore “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc. Mendoj se qëllimi i kësaj kërkesë është shumë i mirë, aty kërkohet rregullimi i sallës së leximit me një inventar, pajisje të tjera që duhet të i ketë një sallë e leximit, po ashtu edhe blerjen e 1000 titujve. Kjo sallë do të shërbejë për nxënësit e komunitetit RAE si në Ratkoc ashtu edhe në rrethinë, përveç kësaj kjo sallë mundet të shërbejë edhe për nxënësit e shkollës sonë si ajo fillore ashtu edhe ajo e mesme. Projekti për këtë sallë është bërë ashtu si ka ditur të bëjë, por nuk do të thotë se ajo që shkruan në atë projekt është përfundimtare. Po ashtu nga ky komunitet ka dalë edhe një kërkesë ose rekomandim, ajo është kërkesa për ndarjen e ndihmave emergjente për rastet sociale për sezonin e dimrit, në bazë të informacioneve që i kemi këto dy kërkesa që kanë dalë nga ky komunitet janë dorëzuar tek zyra e kryetarit, projekti i parë e ka vlerën rreth 10,000.00 €, prandaj kërkesa ime është këto mjete që janë në zyre të ZKK-së të cilat dëshironi që ti ridestini të mos i ridestini por të shkojnë për ndërtimin e kësaj salle të leximit. Mendoj se nëse kërkesat e këtij komiteti nuk mirën parasysh, atëherë nuk është e arsyeshme që të merret kurrfarë initiative në këtë komitet, por nuk ka as çka të mbajë mbledhje atëherë ky komitet.

Ali Zhuniqi – Meqenëse edhe unë jam anëtar i Komitetit për Komunitete është e vërtetë po ashtu që na ka ardhur një projekt nga kryesuesi i këtij komiteti, por unë personalisht nuk mendoj sikurse kolegja ime, sepse ai plan i cili është bërë është bërë në kuadër të buxhetit i cili është i ndarë për komunitete dhe nuk është e arsyeshme që këto mjete përsëri të ri-destinohen, ata e kanë edhe për vitin 2015 një buxhet prej 55,00.00 €, mendoj se nuk kishte me qenë mirë që këto mjete të ridestinohen përsëri aty.

Fehmi Cena – E shoh si endi kep që këtë pikë të rendit të ditës nuk kemi pasur rast që ta shqyrtojmë në KPF, sepse ne aty i kishim dhënë ato vërejtjet dhe sugjerimet tona konkrete, kurse kështu ne në një farë mënyre jemi para një akti të kryer, por megjithatë ne do ti japim disa sugjerime tona dhe do të shohim nëse ka mundësi të ndryshohet diçka rreth kësaj. Tek drejtoria e shërbimeve publike: Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit, nuk jam duke parë diçka konkrete për qytet përveç një kolektori për kanalizim me vlerën prej 10,000.00 € dhe kjo është vetëm lojë asgjë më shumë. Prandaj mendoj se tek ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit kishte me qenë mirë që të precizohet sakët se në qytetin e Rahovecit cilat rrugë do të rregullohen, sepse ka disa rrugë në periferi të Rahovecit që nuk janë marrë fare parasys. Pastaj e kemi një pikë: Ndërtimi i rrugëve Celin – Nagavc, gjatë dëgjimeve publike kemi dëgjuar banorët se shkolla fillore në Nagavc ka probleme me oborr të shkollës, si duket ose oborri e ka nivelin e ulët ose procka që është aty duhet ta ketë nivelin më të ulët, sepse gjithmonë aty ka vërshime sa herë që bije shi. Nëse ka mundësi që shuma mbi 15,000.00 € të i dedikohet pikërisht rregullimit të oborrit të kësaj shkolle. Sa i përket kolektorit nuk e di se çka do të mundeni të bëni me shumën prej 10,000.00. Kurse sa i përket shëndetësisë ajo që nuk e kam të qartë është se këtu e keni cekur edhe ndërtimi i AMF-së në lagjen nr.2 të Rahovecit, pyetje ime është: Për cilën AMF e keni fjalën sepse sa e di unë ka qenë në plan të ndërtohet edhe një ambulancë tek ish objekti i gjimnazit, këtu përtej objektit të policës afër shkollës fillore “Bekim Sylka”. Ridestnimi për shëndetësi ndërtimi i QKMF-së mbi 69,000.00 €, dhe riparimi i objekteve shëndetësore. Të nderuar ne kemi mungesë të pajisjeve medicinale për punë nga ana e punëtorëve shëndetësor konkretisht për mjek, ka një vite e gjysmë që janë pranuar mjekë por nuk kanë pajisje të thjeshta medicinale për të kryer punët e tyre. Vazhdimisht përpilohet kërkesa nga drejtori i QKMF-së drejtuar drejtorit të shëndetësisë por deri më tani ne nuk jemi furnizuar asnjë herë me këto pajisje, kjo është emergjente dhe nëse ka mundësi që të ndahet një buxhet prej 10,000.00 për këto pajisje kishte me qenë shumë mirë. Përndryshe propozimi që u përmend nga znj. Mirjete Krasniqi i cili ka dalë në Komiteti për Komunitete nëse është e lejuar atëherë kishte me qenë mirë që të përkrahet, sepse ajo nuk do të shërbej vetëm për komunitetin RAE por për të gjitha komunitetet që shkojnë në atë shkollë.

Florije Boshnjaku – falënderojmë drejtorin që na ka sjellë këtë propozim për ridestnim të mjeteve të buxhetit sepse ky është interes i të gjitha qytetarëve të komunës së Rahovecit, mendoj dhe shpresoj se asnjëri nga ne nuk është i interesuar që këto mjete të shkojnë në suficit. Në lidhje me atë që propozoi znj. Mirjeta Krasniqi plotësisht pajtohem, por e nderuar këto mjete munden të ridestnohen vetëm në kodet që janë të hapura, nuk munden të hapen kodet të reja, për këtë mundet të na ndihmojë edhe drejtori i financave, është dashur që në fillim të na tregohet se nuk munden të hapen kodet e reja sepse ka disa që e dinë këtë por shumica janë kuvendarë të rijnë dhe nuk i dinë procedurat. Për derisa nuk munden të hapen kodet e reje ne duhet të pajtohemi me këtë propozim që na ka ardhur nga ekzekutivi, ose me propozimet e tjera, por gjithmonë duke pasur parasys kodet. Po ashtu pajtohem me shqetësimin që e paraqiti z. Fehmi Cena por siç e thash ne nuk e kemi këtë kod, nëse nuk ka kod kishte me qenë mirë me e paraparë metodën për të ju siguruar gjërat elementare që ju duhen mjekëve sepse e dhe ky është interes i përgjithshëm i të gjithë qytetarëve.

Besmire Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si grup i PDK-së propozojmë që kodi i bujqësisë tek projekti i kullimit të tokave në fshatin Celinë, shuma prej 100,00.00 € të mos ndahen kështu siç e keni paraparë ju, por kjo shumë të bartet tek projekti i Uljes së niveletës së proit në fshatin Celin, përderisa kjo shumë edhe ashtu ka qenë e destinuar për fshatin Celinë, është mirë që të mbetet përsëri për projektet t këtij fshati.

Dervish Çadraku – Të nderuar projekti i vendosjes së kamerave, pyetje ime është ku do të vendosen këto kamera, në cilat objekte të institucioneve do të vendosen dhe cila është rëndësia e vendosjes së këtyre kamerave. Pastaj tek pika e tretë nëse hiqen këto mjete nga projekti i largimit të qenve endacak, nëse ne e heqim këtë projekt atëherë me qen do na mbushen edhe salla e kuvendit sepse aq shumë ka qen. Pastaj ridestnimi tek drejtoria e shërbimeve publike kemi projektin Investime emergjente në infrastrukturë, nuk e

di se për ku bëhet fjalë, sepse unë jam i interesuar me ditë mos jemi duke hequr mjete aty ku nuk duhet. Kurse tek bujqësia kemi ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit, më duke se për këtë projekt ne i kemi ndarë 50,000.00 € më herët, nëse i kemi ndarë tash kërkoni që të ridestinojmë edhe 24,000.00 €, atëherë për këtë projekt po ndahen 74,000.00 €, si duket atë treg do ta bëni fenomenal, për mua është e tepërt gjithë këto mjete të ndahen për këtë treg. Tek drejtorja e Urbanizmit kemi projektin e ndërtimit të shtatorëve dhe heronjve vlera 57,789,00 €, kurse ridestinimin e kemi tek kompleksi i dëshmorëve në Gradish, pyetje ime është: Kur do të përfundojë ky kompleks? Apo do i përngjaj Urës së Fshejt e cila është ndërtuar ditën kurse është prishur natën, sepse si duket kur nuk do të përfundoj ndërtimi i këtij kompleksi, as me 20,000.00 € e ridestinuara nuk do të ndërtohet ky kompleks. Që të jetë funksional ky kompleks duhet ketë mjete shumë më shumë në mënyrë që të përfundoj ky projekt, këtu sa e di unë do të planifikohen edhe vende të reja të punës. Meqenëse me këto mjete ky kompleks nuk do të përfundoj, atëherë nuk jam i mendimit të që i hiqet shuma prej 20,000.00 € nga projekti i ndërtimit të shtatorëve për heronjtë, së paku ky projekt të përfundoj sa më mirë. Tek shëndetësia kemi dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi 43,495.00 € këto mjete kanë përfunduar, a nuk i keni përdorur fare këto mjete apo nuk keni qenë fare azhur, mendoj se kishte me qenë mirë që këto mjete të i destinonim aty ku duhet në mënyrë që të kryhen punët dhe jo të na mbeten gjysmë të përfunduara.

Afrim Limani – Së pari më lejoni që të ju japë edhe disa informata shpesh të cilat nuk ju dhashë më herët. Procesi i ridestinimit nënkupton bartjen e mjeteve tepërcave nga një projekt në projektin tjetër, në kuadër të programit që i bie në kuadër të drejtorisë, shuma minimale që mundet të bartet është 15% e vlerës së buxhetit që e ka ajo drejtori. Në rastin konkret të gjitha drejtoritë përpos tek zyra e komuniteteve që kemi tepërcë, tek këto tjerat përputhet limiti i përqindjes së nevojshme prej 15%. Pastaj me ridestinim nuk lejohet krijimi i projekteve të reja, kjo është përgjigja edhe për të nderuarën znj. Mirjeta Krasniqi, edhe pse mua më pëlqej propozimi i juaj, por këto janë mjete të grandit për investime kapitale. I nderuar z. Fehmi Cena ka kërkuar që 15,361.00 € të barten nga projekti i ndërtimit të rrugëve në shkollë, ju thash se këto mjete janë në kuadër të programeve pra kodet munden të kalojnë vetëm në kuadër të asaj drejtorie. Sa i përket bartjes në drejtorinë e shëndetësisë e kam këtë informatë pse është bërë, tek projekti dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi, ky projekt ka qenë dy vjeçar dhe pjesa dërmuese e buxhetit është realizuar vitin e kaluar, kurse këtë vit janë realizuar vetëm 10,000.00 € dhe kjo kontratë është mbyllur, dhe tani shuma prej 30,250.00 € për këtë projekt i kemi mjete më tepër. Projekti i Investimeve në pajisje teknologjike edhe këtu kemi mbetje të mjeteve. Kurse ndërtimi i AMF-së në lagjen nr.2 shuma prej 46,000.00 €, ky projekt nuk ka mundur të realizohet për shkak të ndryshme teknike, mirëpo ky projekt është në planifikim edhe për vitin e ardhshëm, pse i ka paraparë drejtori që me i ridestinu këto mjete në kuadër të këtyre dy projekteve më së miri e dinë ai. E nderuara znj. Besa e bërë një propozim shumë me vend, por e nderuar drejtori i bujqësisë së bashku me mua e ka paraparë që këto mjete të i ndajë për secilin projekt nga pak, sepse disa projekt me mjetet e propozuar nga ne do të kryhen, kjo ka qenë arsyeja.

Përparim Krasniqi – Arsyeja pse janë duke u ridestinu mjetet nga drejtorja e shërbimeve publike, shtrohet pyetje pse nga projekti i ndërtimit të rrugës Potoqan i Epërm po tërhiqen mjetet prej 50,000.00 € dhe por ridestinohen në projekte të tjera. Në dhjetor të viti 2017 kompania që ka qenë e kontraktuar për ndërtimin e kësaj rruge e ka dërguar faturën në thesar ku kanë marr mjetet nga thesari, dhe për këto mjete është planifikuar buxheti në shtator dhe kanë kaluar si tepërcë, prandaj është e detyrueshme që ti ridestinojmë mjetet për arsye se janë mjetet e lira. Propozimi për ridestinim të këtyre mjeteve është dhënë në projektin e ndërtimit të rrugëve në komunën e Rahovecit, janë duke u ndërtuar në Rahovec 39 segmente rrugore në Rahovec, kryesisht rrugë lokale jemi në fazën përfundimtare ku na kanë mbetur vetëm edhe 3-4 segmente të pakryera dhe me këto mjete do të paguhet i gjithë borxhi. Ishte po ashtu edhe një pyetje sa i përket vendosjes së kamerave për monitorim, këtu kemi të bëjmë me një projekt i cili në vitin 2017 ka qenë në bashkëpunim me OSBE-në, policin e Kosovës njësisë në Rahovec dhe komuna, projekti ishte vendosja e kamerave në hyrje dhe dalje të qytetit, por shuma prej 10,000.00 € është e pamjaftueshme për tu realizuar

një projekt i tillë, ne kemi kërkuar që të futen në monitorim të kamerave dhe 3-4 vendbanime më të mëdha, ku pastaj do të vendoset një qendër për monitorim të këtyre kamerave. Sa i përket largimit të qenve endacak këtë vite për herë të parë në gjithë Kosovën AVUK-i ka bërë kontratë me 6 regjionet e komunës së Kosovës, që të gjithë qentë endacak të i marrin të i trajtojnë, rehabilitojnë në vendet ku i kanë caktuar ata, këtë kompetencë nuk e kanë pasur komunitat, tani e ka marrë niveli qendror. Kjo ka qenë arsyeja që në këto 10,000.00 € nga projekti për qen endacak i kemi ridestinuuar në borxhet që i kemi ne si komunë.

Berat Duraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, arsyeja pse ne jemi duke i ridestinuuar mjetet është që mos të na shkojnë në suficit, pikërisht projekti i kullimit të tokave bujqësore në lumin Celinë dhe Fortesë nuk po mundet të realizohet për arsye se ne jemi marrë vesh me kryesin e fshatit dhe të zgjedhurit e këtij fshati që janë pjesë e kuvendit, pa u përfunduar projekti i uljes së niveletës së prockës nuk mundet të vazhdohet projekti i cili është në vazhdim kullimi i tokave bujqësore. Ne e kemi bërë në fillim revidimin e projektit i cili në fillim ka qenë vetëm hapja e një kanali, kurse ne e kemi shndërruar në kanal me beton dhe me standarde tjera, mbase dinamikës së kryerjeve të punës në teren dhe në bazë të planit të menaxhimit të kontratës kemi konsideruar se kaq mundet të punohet këtë vit, edhe pse ne kemi mundur të gjitha këto mjete të i ridestinojmë në këtë projekt, por përsëri na kishin mbetur të pa shfrytëzuara për këtë vit sepse tani jemi në stinë dimri dhe nuk ka mundësi që të punohet më shumë. Këto ishin arsyetimet e mija pse ne si drejtori i kemi ridestinuuar mjetet.

Rumir Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket ridestinitimit të mjeteve nga projekti i ndërtimit të shtatorëve të heronjve tek disa projekte të tjera që ne i kemi propozuar që të ridestinohen. Ndërtimi i shtatorëve për heronj në komunën tonë kanë ngecur tek tre shtatore, ato janë: Shtatorja e “Shejh Mehidinit”, “Menzur Zyberaj” dhe e “Bedrush Gashi”, familjet të cilët kanë kërkuar që këto shtatore të ndërtohen, tani familjet nuk janë të pajtimit që të vendosen shtatore në ato ku komuna i ka caktuar që të vendosen këto shtatore, prandaj këtë vite këto projekte nuk mundin që të realizohen. Prandaj që mos të i humbim këto mjete ne kemi propozuar që të ridestinohen në projektet e tjera të cilat ne kemi menduar se janë më të arsyeshme. Pyetje tjetër ishte se kur do të përfundoj kompleksi, në këtë vit i kemi paraparë vetëm 20,000.00 € sepse aq kemi menduar që mundet të punohet këtë vit, por ne për këtë projekt edhe në buxhetin e viti 2019 kemi planifikuar mjete në mënyrë që të përmbillet komplet ky projekt.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin për Ridestinitim të mjeteve në buxhetin e vitit 2018: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e shtatë (7) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

8. Informatë e tretë mbi ecurinë e hartimit të PZHK-së.

Rumir Zhuniqi – Po ju paraqes informatën e tretë mbi ecurinë e PZHK-së, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ka vazhduar procesin hartimit në bazë të programit të hartuar nga kuvendi komunal dhe në bazë të ligjit për planifikim hapësinor. Nga Skenarët e planifikimit hapësinor kemi propozuar që komuna e Rahovecit të një Qendër kryesore urbane (Rahoveci) dhe në gjashtë nën qendra (Krusha e Madhe, Opterusha, Ratkoci, Drenoci, Xërca dhe Çifllaku). Secila nën qendër si kriter e ka që ti i ketë së paku 5000 banorë, dhe këto nën qendra i plotësojnë kushtet sipas planifikimit policentrik, që komuna jo të fokusohet vetëm në një qendër si është qyteti, por të fokusohet edhe në këto nën qendra. Ne kemi vazhduar me prezantimin e PZHK të draftit në të gjitha nën qendrat, ku ditën e djeshme e kemi përmbyllur me tubimet me qytetarë i cili është detyrim ligjor në mënyrë që të përmbushet hartimi i PZHK-së. Gjithashtu ne i kemi propozuar edhe kufijtë ndërtimorë të secilit vendbanim duke u bazuar në propozimet e drejtorisë sonë nga sektori i urbanizmit dhe planifikimit hapësinorë, të vendimeve të komunës dhe ligjeve të planifikimit hapësinorë. Ne këtë do e prezantojmë edhe në MMPH e cila është kërkesë edhe e programit, por edhe e ligjit, pastaj pas pëlqimit nga MMPH ky plan do të dele në shqyrtim publik për 30 ditë, ku pastaj do të vijë në kuvend për aprovim.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendar me kaq përfundon mbledhja e sodit, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.
Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 15:45

01 Nr. 3156
Rahovec, 27.11.2018

Procesmbajtësi

Skender Hamza

